



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 21 janar 2010
Ref.: Nr. MP-01/10

VENDIM
mbi kërkesën për masa të përkohshme
në

Lëndën nr. Kl. 41/09

Universiteti AAB-RIINVEST shpk, Prishtinë
kundër
Qeverisë së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në përbërjen për sa vijon:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Me znj. Njomza Uka, Zyrtare për regjistrimin e rasteve, në cilësisë të mbajtëses së procesverbalit në shqyrtimet dhe vendimmarrjen e Gjykatës mbi Kërkesën për masa të përkohshme, që u mbajt më 25 nëntor 2009, përkitazi me Lëndën nr. Kl 41/09, të iniciuar nga

Kërkuesi

1. Kërkuesi quhet "Universiteti AAB-RIINVEST", me zyre qendrore në Prishtinë, përfaqësuar nga Sekretari i tij, Granit Curri.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Objekti i shqyrtimit

3. Kërkesa e parashtruar nga kërkuesi më 23 shtator 2009 për shqiptimin e masave të përkohshme përkitazi me lëndën nr. Kl. 41/09, të parashtruar nga "Universiteti AAB-RIINVEST".

Baza juridike

4. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Kushtetuta), neni 27 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Ligji), dhe neni 52(1) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Rregullorja e punës).

Faktet

5. Përmes vendimit nr. 01/73 datë 7 korrik 2009, të marrë në mbështetje të neneve 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës dhe nenit 4.3 të Rregullores mbi funksionet e Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe bazuar në rekomandimet e Këshillit Kombëtar për Cilësi të Këshillit të Akreditimit të Kosovës, Qeveria mori vendim, në pajtueshmëri me rekomandimet e KKC-së dhe AAK-së, që t'i jep emrin "Kolegj" për AAB-RIINVEST, në këtë mënyrë duke kufizuar numrin e studentëve që do të regjistrohen në vitin akademik 2009/2010 të 500.

6. Më 23 shtator 2009, Kërkuesi parashtroi ankesë kushtetuese, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit nr. 01/73 të Qeverisë, përmes së cilit Parashtruesit të kërkesës i jepet emri "Kolegj".

Ankesat e parashtruesit të kërkesës

7. Kërkuesi parashtroi kërkesë më 23 shtator 2009, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit nr. 01/73, të marrë nga Qeveria më 7 korrik 2009, përmes së cilit Kërkuesit i jepet emri "Kolegj" në vend të atij "Universitet".

8. Po ashtu, Kërkuesi kërkoi që Gjykata të shqiptojë një masë të përkohshme për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit në fjalë. Ai konsideron se janë përmbushur kërkesat e nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesi propozon që të shqiptohet masa e përkohshme përkitazi me emrin "Kolegj" si dhe kufizimin e numrit të studentëve të rinj që do të regjistrohen në vitin akademik 2009/2010.

9. Kërkuesi gjithashtu argumenton që, nëse Vendimi vazhdon të jetë në fuqi, ka rrezik të vërtetë të dëmeve të pakthyeshme, duke shkaktuar që aktiviteti dhe biznesi i tij, si një nga ofruesit e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, të ndalohet apo të vështirësohet në masë të madhe, meqë do të kufizonte numrit e studentëve të rinj të regjistruar në vitin akademik 2009/2010 në 500. Gjithashtu, ai ka sugjeruar që masa e përkohshme të zgjasë deri në lëshimit të Vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës.

Përgjigja e Palës kundërshtare

10. Pala kundërshtare, të cilës i është komunikuar Kërkesa nga ana e Zyrës për regjistrimin e kërkesave të Gjykatës më 2 tetor 2009, nuk i pa parashtruar komentet e saj në afatin kohor prej 45 ditëve, siç përcaktohet me nenin 22(2) të Ligjit.

GJYKATA KUSHTETUESE

11. Pasi që ka dëgjuar Gjyqtarin raportues, znj. Snezhana Botusharova, si dhe pasi që ka diskutuar parashtrimet e Kërkuesit përkitazi me Kërkesën e tij për masa të përkohshme, mbajti seancë këshillimi më 25 nëntor 2009. Gjykata përfundoi se, pa paragjykuar në rezultatin përfundimtar të Kërkesës, Kërkuesi nuk ka ofruar asnjë argument apo dëshmi se, gjatë gjykimit të Kërkesës, Gjykata duhet të pezullojë Vendimin nr. 01/73 të Qeverisë përkitazi me emrin "Kolegj" si dhe numrin e studentëve që Kërkuesit i lejohet për regjistrim në vitin akademik 2009/2010.

12. Prandaj, Kërkuesi nuk ka provuar dëmet e pakthyeshme që pohon se do t'i pësojë apo se kjo masë do të ishte në interesin publik, nëse Gjykata do të shqiptonte një masë të tillë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116(2) të Kushtetutës, nenit 27(1) të Ligjit, dhe nenit 52(1) të Rregullores së punës, përmes votimit të shumicës,

VENDOSI

I. QË TË REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme;

II. Palët do të njoftohen me këtë Vendim.

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Snezhana Botusharova, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.